



# Ridomil Gold®

## Combi 45 WG

<b>Lënda vepruese:</b>	Metalaxyl-M & Folpet
<b>PËRMBAJTJA:</b>	Metalaxyl-M: 5% Folpet: 40% Lëndë ndihmëse: 55%
<b>Numri i regjistrimit:</b>	AL: 27/ 24.05.2004 KS: 106-0970-11-2007/27.03.2007
<b>Formulimi:</b>	Granula të dispergueshme në ujë

### FUNGICID SISTEMIK, ME VEPRIM PARAMBROJTËS DHE SHËRUES, SPECIFIK PËR KONTROLLIN E VRUGUT TË HARDHISË

**PËRDORIMI:** Përdoret në HARDHI kundër **vrugut** (*Plasmopara viticola*) me dozë 200 gr/100 litra ujë. Kryhen 3-4 trajtime gjatë vegjetacionit. Bëhen trajtime parambrojtëse (kur kushtet e motit favorizojnë shfaqjen e vrugut), që fillojnë në fazën e rritjes intensive dhe përsëriten çdo 10 – 14 ditë.

**VËREJTJE:** RIDOMIL GOLD COMBI 45 WG ka efekt të pjesëshëm kundër **Nekrozës së hardhisë** (*Phomopsis viticola*), **Kalbëzimit gri** (*Botrytis cinerea*), **Kalbëzimit të zi të rrushit** (*Guignardia bidwelli*) dhe **Njolloshjes së kuqe të hardhisë** (*Pseudopeziza tracheiphila*).

**MËNYRA E PËRDORIMIT:** Me spërkatje.

**MËNYRA E PËRGATITJES SË TRETËSIRËS SPËRKATËSE:** Mbushni me ujë deri në mes pompën spërkatëse dhe filloni përzierjen. Hidhni dozën e duhur të preparatit, duke vazhduar përzierjen, dhe plotësoni pompën me sasinë tjetër të ujit

**FITOTOKSICITETI:** Nuk është fitotoksik kur përdoret në kulturat dhe dozat e rekomanduara. Të mos përdoret në fidanishtet e hardhisë.

**PËRZIHET** me shumicën e fungicideve dhe insekticideve që përdoren në hardhi.

**SPËRKATJA E FUNDIT PARA VJELJES:** Hardhi 21 ditë.

**PERIUDHA DHE KUSHTET E RUAJTJES:** 2 vjet. Preparati ruhet në kuti të mbyllura, në vende të thata e të ftohta. Evitoni ruajtjen në temperatura nën -10° C dhe mbi 35° C. Preparati të mos mbahet në diell e në lagështi.

## MASAT PARAMBROJTËSE

-Evito kontaktin me sytë dhe lëkurën. –Mbro rrugët e frymëmarrjes duke përdorur mjetet mbrojtëse. -Mos ha dhe mos pi ujë e duhan gjatë përdorimit. -Pas punës duart dhe fytyra duhet të lahen dhe rrobat të ndërrohen. -Gjatë punës përdorni mjetet mbrojtëse. -Lani pajisjet mbrojtëse para se ti ripërdorni.

## UDHËZIME PËR NDIHMËN E PARË DHE KËSHILLA PËR MJEKUN:

-Në rast kontakti me sytë ose lëkurën i lani menjëherë me ujë të bollshëm e sapun.  
-Në rast se merret me organet e frymëmarrjes nxireni të aksidentuarin në vende të ajrosura. –Në rast gëlltitje jepini në mënyrë të përsëritur karbon aktiv dhe ujë të bollshëm. Çojeni të aksidentuarin në spital dhe i tregoni mjekut etiketën e produktit. Antidot specifik nuk njihet. Mjekimi simptomatik. Tel. Urgjence: +44 1484 538 444.



## HELMUES PËR PESHQIT DHE PËR ORGANIZMAT UJORE.

Mos ndotni burimet ujore që përdoren për qëllime shtëpiake, ujitje etj. me mbeturinat e ambalazheve ose solucionin spërkatës.

**TË RUHET NË VENDE TË SIGURTA DHE LARG FËMIJËVE.**

**PRODHUESI:** SYNGENTA Crop Protection AG,  
Basel, Switzerland  
Tel: +41 61 323 11 11 ; Fax:+41 61 323 12 12